



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 79, DATË 03.09.2020

PËR
SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË “PRIAM NET” SH.P.K., PËR
RINOVIMIN E AUTORIZIMIT DHE ZGJERIMIN E ZONËS SË OFRIMIT TË
SHËRBIMIT, PËR PËRSËRITJEN E SHËRBIMIT TË PROGRAMIT AUDIOVIZIV
TË TË TRETËVE MBËSHTETUR NË RRJET KABLLOR “TV KABLLOR MANZA”

Në mbështetje të nenit 19, pika 1/b, nenit 55, pika 4/b dhe nenit 64, pika 5 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe rregullores “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së autorizimeve”, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 99, datë 07.06.2017, si dhe pas shqyrtimit të aplikimit nr. 1906 prot., datë 08.07.2020, të shoqërisë “Priam Net” sh.p.k, Autoriteti i Mediave Audiovizive,

VENDOSI:

1. Rinovimin e autorizimit të shoqërisë “Priam Net” sh.p.k., me administrator: Xhaferr Beqja dhe NIPT L82029503P, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Manza”, në njësinë administrative Manëz, për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.
2. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë “Priam Net” sh.p.k., për zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Manza”, në njësitë administrative Sukth dhe Maminas, pasi aplikimi nuk është i plotë.
3. Kushtet e autorizimit të subjektit për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Manza”, mbeten të pandryshuara.

Ky vendim për pikën 1 i shtrin efektet prej datës 13.07.2020, ndërsa për pikën 2, hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:

Gentian

SALA

Zëvendëskryetar:

Sami

NEZAJ

Anëtarë:

Agron

GJEKMARKAJ

Gledis

GJIPALI

Suela

MUSTA